



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.384/2016

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, gjyqtari Naim Mehulli, në çështjen juridike të paditësve A.S.1, F.S, E.S. dhe A.S.2. që të gjithë nga te cilët i përfaqëson Av.RK nga, , kundër të paditurës Komuna e, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 51.400.00 euro, me datën **31.10.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve A.S.1, FS, ES dhe AS.2. që të gjithë nga, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, t'ia paguajnë paditësve shumën e përgjithshme prej 51.400.00 euro (pesëdhjetë e një mijë e katërqind euro), si dhe t'ia paguajnë shpenzimet procedurale në shumë 277,40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, **si tërësisht e pabazuar**.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit AS me dt....., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës, përmes se cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material në shumën e përgjithshme prej 51.350.00 euro, mirëpo me parashtrësë te datës 18.06.2018 është zgjeruar padia ne aspektin subjektiv ku përveç paditësit te lartcekur, si paditësi janë paraqitur edhe F.S, E.S dhe A.S ku është bere edhe precizimi i kërkesë padis ashtu qe shuma te cilin e kanë kërkuar paditësi ne emër te demit material dhe jo material është 51.400.00, gjykata ne seancën e datës 29.10.2018 e ka lejuar zgjerimin-precizimin e kërkesëpadisë. Ne referatin e paditës dhe parashtrësën për zgjerimin e padis, paditësit kanë cekur faktin se me datën 28.01.2014 rreth orës 09:18 ne korridorin e SHML “....., FH me thikë xhepi e ka goditur ne anën e majtë te gjoksit A.S, plagë nga e cila vjen gjer te shoku hemorogjen dhe si pasoj e kësaj A.S vdes. I ndjeri pas

vetes ka len paditësit dhe atë babin A.S, nenën V.S dhe vëllezërit E.S dhe A.S.

Ka shtuar se për shkak të humbjes së anëtarit të familjes pa fajin e paditësve, ata përjetuan dhimbje të intensitetit të madh, andaj për këtë arsye kërkojnë kompensimin e demit material për hargjime të varrimit dhe hargjime për ngritje të lapidarit shumen prej 1400 euro dhe në emër të demit jo material për dhimbje shpirtërore shumen prej 50.000,00 euro, dhe atë për dhimbje psikike për nenën dhe babin e tani të ndjerit A.S shumen për secilin nga 15.000,00 euro dhe për dhimbje psikike për vëllezërit shumen prej nga 10.000,00 për secilin apo shumen e tërësishme 51.400.00 euro (pesëdhjetë e një mijë e katërqind euro).

Gjykata me datën 29.10.2018 ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën morën pjesë i autorizuari i paditësve dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditësve për gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: dua që të akceptoi **Komunën e** si të paditur sepse i tërë financimi shkon përmes saj, prandaj ka qenë lëshim në aspektin e akceptimit të Komunës prandaj e paditur është Komuna e pasi që e njëjta menagjon edhe me drejtori përkatëse. Ka shtuar se mbetemi në tërësi pranë padisë së ngritur dhe zgjerimit të saj me datë 18.06.2018 dhe sot theksoj se shuarjen e jetës së një individi bie në fushën e mbrojtjes së integritetit trupor individual e cila në rastin konkret manifeston në trajtën e saj me të vrazhde vdekjen e A.S. Subjektivisht për këtë vdekje është përgjegjëse i gjykuari F.H. të cilin Gjykata Themelore në Mitrovicë P.nr të datës 19.06.2015 e ka shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes nga neni 178 të KPRK dhe i ka gjykuar me 11 vite burg duke vendosur sipas ankesës së tani të dënuarit aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar vetëm për vendimin mbi dënimin, ashtu që F.H e kanë dënuar me 9 vite burg. Theksoj se shkolla ku ka ndodhur rasti ka **përgjegjësi objektive** mu për faktin se të gjithë në si prindër i dërgojmë fëmijët tone që të mësojnë e arsimohen dhe avancohen e jo të na kthehen fëmijët kufoma. Në kërkojmë që familjes së të ndjerit t'i kompensohet demit material ku hyjnë harxhimet e varrimit dhe demit jo material ku hyjnë traumat, dhimbjet psikike për prindër dhe vëllezërit. Shpenzimet e procedurës i kërkoj për taks gjyqësore shumen prej 41 euro, për padi 101,40 euro dhe për një përfaqësim shumen prej 135 euro apo shumen e tërësishme në emër të shpenzimeve kontestimore 277, 40 euro.

Ndërsa përfaqësuesi i të paditurës për gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroj se: e kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë si dhe zgjerimin e padisë duke insistuar që në rastin e kësaj padie Komuna e ka pasivitet legal sepse nxënësit (të dy nxënësit) A.S i vdekur dhe F.H (vrasësi) edhe pse kanë qenë nxënës të shkollës së mesme teknike "....." në, të dy në ditën kritike me 28.01.2014 i kanë pasur mbi 20 vite, andaj rasti i

ndodhur me po këtë datë ka tronditur komplet sistemin arsimor te qytetit tonë dhe njëkohësisht qytetaret e **Komuna e** ne rastin konkret si institucion e ceku edhe me larte ne këtë çështje ka pasivitet legal për te qene pale e paditur sepse ne asnjë moment nuk ka qene i involvuar asnjë nga zyrtaret e shkollës, mësimmdhënësit apo punëtoret teknike ne zënkën mes te dy nxënësve. Siguria ne shkolle mund te themi qe ka pasur disa norma sepse kamerat ekzistojnë ne shkolle edhe ky rast ka qene i incizuar prej kamerave te shkollës qe ka qene edhe lehtësim për institucionet tjera te Kosovës. Ne si institucion e kuptojmë dhimbjen e familjareve te viktimës mirëpo mos pasja mundësi qe ne ditën kritike te kenë çfarëdo roli ne këtë incident ne kundërshtojmë padinë dhe kërkojmë nga gjykata qe ne mungese te **pasivitetit legal te Komunës se** si institucion qe menaxhon me DKA dhe Shkollën e mesme teknike te sjell vendim meritor lidhur me kërkesën tone qe kjo padi te refuzohet për shkak te mungesës se legjitimitetit pasiv të te paditurës.

Me qellim te vërtetimit te plot te gjendjes faktike gjykata administroi këto prova: Aktakuza nga Prokuroria Themelore Mitrovice PP..... e dt., certifikata e vdekjes për tani te ndjerin A.S i dt., lëshuar nga Ministria e Drejtësisë Instituti i Mjekësisë Ligjore, certifikata martesore e paditësit te pare dhe te dyte – prindërve te viktimës te dt. 21.06.2016, ekstrakti i lindjes për tani te ndjerin A.S i dt. 21.06.2016, ekstrakti i lindjes për paditësin e tret E.S i dt. 21.06.2016, certifikata e lindjes te paditësit te katërt A.S i dt. 21.06.2016, kopjet e letërnjoftimit për paditësit, aktgjykimi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti për krimet e Rënda P.nr.127/2014 i dt. 19.06.2015, aktgjykimi i Gjykatës se Apelit te Kosovës PAKR.nr.354/15 i dt.07.09.2015.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave qe gjenden në shkresat të lëndës dhe deklarimeve-pretendimeve te palëve për gjatë shqyrtimit gjyqësor, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se **kërkesëpadija e paditësve në raport me të paditurën Komuna e, është e pabazuar.**

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se me datën 28.01.2014 rreth orës 09:18 ne korridorin e SHML “” ka humbur jetën A.S, pas një mosmarrëveshje ne mes tani te ndjerit A.S dhe F.H i cili ditën kritike me thikë xhepi e godet ne anën e majtë te gjoksit tani te ndjerin duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse te cilat kanë qar deri te vdekja e te ndjerit, kjo vërtetohet nga Certifikata e vdekjes me numër datës 28.06.2016, e po ashtu kjo vërtetohet edhe me Aktgjykimi penal lëshuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës P.nr.127/2014 datës 19.06.2015 dhe me Aktgjykim penal lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës PAKR.nr.354/2015 datës 07.09.2015, po ashtu per gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësit A.S.1. dhe V.S kanë qenë prindërit e tani te ndjerit A.S. ndërsa paditësit e tjerë E.S dhe A.S.2 kanë qenë vëllezërit e

tani te ndjerit, kjo vërtetohet nga certifikatat e paditësve që gjenden në shkresat e lendes si dhe certifikata e lindjes së tani te ndjerit A.S.

Gjykata nga provat që gjenden në shkresat e lendes ka vërtetuar faktin se shkaktar apo përgjegjës kryesor i vdekjes së tani te ndjerit A.S ka qenë F.H, kjo vërtetohet me aktgjykimet lëshuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës P.nr.127/2014 datës 19.06.2015 dhe me Aktgjykim penal lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës PAKR.nr.354/2015 datës 07.09.2015.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me kompensimin e dëmit material dhe jo material për të cilin paditësit pretendojnë se shkaktar i dëmit është Komuna e si institucion që menaxhon me Shkollën dhe se në rastin konkret e njëjta ka përgjegjësi objektive mu për faktin se fëmijët i qojnë në shkollë për të mësuar, arsimuar dhe që të avancohen e jo të na kthehen fëmijët kufoma. Gjykata pretendimet e tilla nga ana e paditësve i refuzoi si të pa bazuara për faktin se bazuar në shkresat penale është vërtetuar fakti se përgjegjës apo shkaktar i këtij dëmi është vetëm personi fizik dhe atë nxënësi F.H i cili është dënuar për veprën penale vrasje nga neni 178 të KPRK, ndërsa me asnjë provë që gjendet në shkresat të lendes nuk është vërtetuar se ka lëshime nga stafi apo Institucion Arsimor i të paditurës.

Sa i përket pretendimit të autorizuarit të paditësve se e paditura si menaxhuese e Shkollave ka përgjegjësi objektive për dëmin e shkaktuar, këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se bazuar në nenin 154 të LMD-se është përcaktuar se përgjegjësia objektive rrjedh nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme, ndërsa në rastin konkret e paditura nuk ushtron veprimtari të rrezikshme e as nuk është send i rrezikshëm prandaj të njëjtës i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë e paditur në këtë çështje juridike, aq më tepër kur përgjegjës është shpallur dhe dënuar personi fizik përkatësisht nxënësi F.H.

Duke qenë se u vërtetua se e paditura në rastin konkret nuk mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar, **e njëjta nuk ka legjitimacion real pasiv** në këtë çështje juridike kontestimore, ngase siç edhe u cek më lartë, përgjegjës (fajtor) është shpallur kryerësi i veprës penale nxënësi F.H, andaj padia e paditësve për kompensim dëmi material dhe jo material, kundër të paditurës Komuna e, u deshtë të refuzohet si e pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 154 të LMD-se, lidhur me nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 450 të LPK-së, kjo për faktin se e paditura Komuna e nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.384/2016, datë 31.10.2018

G j y q t a r i,
Naim Mehulli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.